

UDHËZIM
Nr. 22, datë 14.9.2012

**PËR NJË NDRYSHIM DHE DISA SHITESA NË UDHËZIMIN NR. 21, DATË 30.7.2009 “PËR
PROCEDURAT E PRANIMIT DHE TË REGJISTRIMIT NË PROGRAMET E STUDIMIT TË
DOKTORATËS, NË INSTITUCIONET PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, të nenit 26 pika 1.3 e vijues dhe nenit 61 pika 2 të ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, si edhe vendimit nr. 864, datë 5.12.2007 të Këshillit të Ministrave “Për hapjen e programeve të studimit të doktoratës, në institucionet e arsimit të lartë dhe përcaktimin e kushteve, që duhet të plotësojë studenti për marrjen e diplomës për gradën shkencore “Doktor”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

I. Në udhëzimin nr. 21, datë 30.7.2009 “Për procedurat e pranimit dhe të regjistrimit në programet e studimit të doktoratës, në institucionet e arsimit të lartë”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

i) Në titull fjala “... publike ...” hiqet.

2. Pika 2 ndryshon si më poshtë vijon:

“2. Për t’u pranuar në një program studimi të doktoratës, kandidati duhet të zotërojë diplomë të ciklit të dytë të studimeve “Master i shkencave” dhe të çdo diplome tjetër të vlerësuar të barasvlershme me të, në fushën e programit të doktoratës apo në një fushë të përafërt të përcaktuar më parë në rregulloren e programit përkatës të doktoratës.”.

3. Pas pikës 5 shtohet pika 5/1 me përmbajtje, si vijon:

“5/1. Doktorantët udhëhiqen nga personeli akademik i disiplinës respektive të studimit të doktoratës, me titullin “Profesor” ose “Profesor i Asociuar” ose me gradën shkencore “Doktor” (PhD) të fituar pranë universiteteve perëndimore. Udhëheqësi shkencor me titullin akademik “Profesor”, i punësuar me kohë të plotë, udhëheq njëkohësisht jo më shumë se pesë doktorantë. Udhëheqësi shkencor me titullin akademik “Profesor i Asociuar” dhe udhëheqësi shkencor me gradën shkencore “Doktor” (PhD) të fituar pranë universiteteve perëndimore, i punësuar me kohë të plotë, udhëheq njëkohësisht, jo më shumë se dy doktorantë. Udhëheqësi me titullin akademik “Profesor”, i punësuar me kohë të pjesshme, udhëheq vetëm një doktorant.”.

II. Ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit të Lartë në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë, si dhe institucionet e arsimit të lartë, të cilat ofrojnë programe studimi të doktoratës, për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS
Myqerem Tafaj